

LIGJ
Nr. 79/2023

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 57/2019, “PËR ASISTENCËN SOCIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

Neni 1

Në fund të pikës 1 të nenit 9 shtohen fjalët “të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Neni 2

Shkronja “a” e nenit 11 ndryshohet si më poshtë:

“a) shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.10.2023.

Shpallur me dekretin nr. 308, datë 26.10.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.